



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"



GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN

Nr. 386 Prot., datë 06 / 02 /2025

Nr. 255 Prot., datë 06 / 02 /2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

DHE

**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**

(INTERNSHIP)

"PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKËS PROFESIONALE"



SHKURT 2025, ELBASAN, SHQIPËRI

PREAMBULA

Sot më datë, ____/____/2025 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" i përfaqësuar nga Rektorja Prof. Dr. Elvira Fetahu dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e përfaqësuar nga Zv/Kryetari z. Artur Prenga të cilat këtu e më poshtë do të referohen bashkërisht si Palët dhe vecmas si Pala.

Duke njohur rëndësinë e përgatitjes profesionale të studentëve dhe domosdoshmërinë e lidhjes midis arsimit teorik dhe praktikës profesionale, si dhe duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë dhe sistemin gjyqësor, palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje për zhvillimin e programit të Praktikës Profesionale për studentët e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Elbasan, sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Objekti

1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është nxitja dhe aftësimin në praktikë i formimit profesional të studentëve nëpërmjet punës.

Neni 2

Qëllimi

2.1 Kjo marrëveshje synon të mundësojë zhvillimin e praktikës profesionale (internship) për studentët e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

2.2 Qëllimi kryesor është të ndihmohet zhvillimi i aftësive profesionale të studentëve si dhe të ofronet një përvojë praktike dhe mbikëqyrje profesionale në përputhje me standardet dhe kërkesat e sistemit gjyqësor të Republikës së Shqipërisë.



Neni 3

Baza Ligjore

3.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në Ligj nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Ligj nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligj Nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Ligj Nr.9131 datë 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”; Ligj Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Neni 279 i K.Pr.Penale “Detyrimi për të ruajtur sekretin hetimor”.

3.2 Palët angazhohen të respektojnë të gjitha rregulloret dhe politikat e brendshme të institucioneve përkatëse.

3.2 Çdo ndryshim në kuadrin ligjor gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes do të reflektohet me anë të një aneksi plotësues të nënshkruar nga palët.

Neni 4.

Përgjegjësitë e Palëve

4.1 Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” angazhohet në:

- I. Përzgjedhjen e studentëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara për pjesëmarrje në programin e internshipit, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Elbasanit, kuadrin ligjor të tij, si dhe dispozitat ligjore të sistemit gjyqësor dhe kërkesat specifike të Gjykatës.
- II. Monitorimin dhe vlerësimin e ecures së studentëve në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga kuadri ligjor dhe rregulloret e brendshme të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, si dhe me kërkesat e sistemit gjyqësor, duke synuar garantimin e standardeve të larta të cilësisë dhe performancës gjatë praktikës profesionale.
- III. Sigurojë zhvillimin e një programi orientues të përbashkët për avancimin profesional të studentëve, në përputhje me standardet e sistemit gjyqësor. Gjithashtu, të monitorojë dhe



vlerësojë ecurinë e studentëve gjatë praktikës profesionale, në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Gjykatën.

4.2 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan angazhohet të:

- I. Sigurojë një ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për zhvillimin e praktikës profesionale, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet normative të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Gjithashtu, të garantojë respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e sekretit profesional.
- II. Caktojë një mentor të specializuar, i cili do të mbikëqyrë dhe udhëzojë studentët gjatë praktikës profesionale, duke garantuar respektimin e standardeve profesionale, etikës dhe parimeve të ndershmërisë në realizimin e veprimtarive praktike.
- III. Përfshijë studentët në aktivitete edukative dhe praktike, të lidhura ngushtësisht me funksionimin e përditshëm të gjykatës, duke ruajtur parimet e pavarësisë dhe integritetit të procesit gjyqësor, si dhe duke siguruar që drejtësia dhe konfidencialiteti i çështjeve gjyqësore të mos çënohen asnjëherë.
- IV. Hartimin e raporteve të rregullta dhe të detajuara mbi performancën për secilin student, për t’u siguruar që ata po zhvillojnë aftësi praktike dhe po përmbushin detyrat e tyre profesionale.

Neni 5

Përgjegjësitë Ligjore dhe Etike

5.1 Studentët duhet të respektojnë normativën ligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e sekretit profesional, përfshirë, por jo kufizuar në, **Ligj Nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”** dhe çdo akt tjetër ligjor të lidhur me mbrojtjen e informacionit konfidencial.

5.2 Çdo shkelje e rregullave dhe detyrimeve të përcaktuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në lidhje me etikën profesionale, konfidencialitetin dhe të drejtat e palëve të përfshira në proceset gjyqësore, do të rezultojë në përfundimin e menjëhershëm të programit të praktikës profesionale, në përputhje me procedurat disiplinore dhe dispozitat ligjore të aplikueshme.



Neni 6

Mekanizmi i Vlerësimit të Studentëve

- 6.1 Performanca e studentëve do të vlerësohet në bazë të detyrave të kryera, aftësive praktike të demonstruara dhe përkushtimit të tyre gjatë praktikës profesionale.
- 6.2 Raporti përfundimtar mbi performancën e studentëve do të përgatitet nga mentori i Gjykatës dhe do t'i dorëzohet Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për vlerësim akademik.
- 6.3 Mekanizmat e vlerësimit do të respektojnë dispozitat e ligjit për arsimin e lartë, duke siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse. Vlerësimi do të bëhet në përputhje me standardet e cilësisë akademike, duke u bazuar në kritere objektive dhe të qarta, që përfshijnë detyrat e kryera, aftësitë praktike të demonstruara, përkushtimin dhe zhvillimin e studentëve gjatë praktikës profesionale.

Neni 7

Promovimi dhe Raportimi Publik

- 7.1 Palët bien dakord për promovimin e këtij bashkëpunimi përmes aktiviteteve publike dhe informuese, të tilla si konferenca, seminare dhe publikime në faqet zyrtare të UE-së dhe Gjykatës, në mënyrë që të rritet transparenca dhe ndërgjegjësimi për praktikën profesionale dhe arritjet e tij. Palët bien dakord për promovimin e këtij bashkëpunimi përmes aktiviteteve publike dhe informuese, të tilla si konferenca, seminare dhe publikime në faqet zyrtare të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me qëllim rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin për praktikën profesionale duke theksuar arritjet e saj, si dhe inkurajimin e përfshirjes së studentëve në aktivitete praktike që kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe njohurive të specializuara.
- 7.2. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan do të bashkëpunojnë për hartimin e një raporti të përbashkët, i cili do të pasqyrojë rezultatet dhe impaktin e programit të internshipit. Ky raport do të shërbejë si një shembull i mirë dhe model për zhvillimin e bashkëpunimeve të tilla të mundshme mes dy institucioneve. Ky raport do të theksojë përfitimet e ndërsjella,



Neni 9

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

9.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe mbetet e vlefshme për ____ vite. Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të rinovohet me marrëveshje të shkruar nga të dyja palët.

9.2 Çdo ndryshim në Marrëveshje duhet të bëhet me pëlqimin e të dyja palëve dhe të formalizohet me shkrim.

Neni 10.

Personat e kontaktit

10.1 Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër.

10.2 Në castin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:

Për Universitetin “Aleksandër Xhuvani”:

z/znj.

E-mail:

Per Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan:

z/znj.

E-mail:

10.3 Personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve proces-verbaJeve dhe cdo dokumenti shoqëruar që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes.

10.4 Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) javësh kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 11

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve



11.1 Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet negociatave midis palëve. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet, ajo do të trajtohet sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipëri.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj, është përgatitur në dy kopje origjinale, një për secilën pale dhe ka fuqi të barabartë ligjore.

Hyn në fuqi sot më datë ____/____/2025

**PËR UNIVERSITETIN E ELBASANIT
“ALEKSANDËR XHUVANI”**



**PËR GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN**

